

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Gusht 2026

10.09.2026

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin gusht 2026, duke zbatuar klasifikimin e ri COICOP 2018, me vit bazë 2025 = 100 dhe metodologji të përditësuar.

Shkalla e rritjes së çmimeve të konsumit në gusht 2026 ishte 7,3 % vjetore dhe 1,3 % mujore

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte më i lartë në një mesatare prej 7,3 % në muajin gusht 2026, krahasuar me muajin gusht 2025. Inflacioni mujor ishte 1,3 % në muajin gusht 2026.

Gusht 2026 / Gusht 2025 7,3 %


Në muajin gusht 2026, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është rritur me 7,3 % krahasuar me muajin gusht 2025. Rritja është ndikuar nga grupet kryesore të COICOP-it: transporti (21,1 %), strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (11,8 %), restorante dhe shërbime akomodimi (5,4 %), pije alkoolike, duhan dhe narkotikë (5,1 %), shëndetësi (4,2 %), kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme (3,8 %), mobilje, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinore shtëpiake (3,4 %), rekreacion, sport dhe kulturë (3,4 %), veshje dhe këpucë (3,0 %), ushqime dhe pije joalkoolike (2,6%) dhe informacion dhe komunikim (0,6 %).

Ndërkohë, rënie e çmimeve është regjistruar në grupin: shërbimet arsimore (-0,5 %).

Gusht 2026 / Korrik 2026 1,3 %

Në muajin gusht 2026, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është rritur me 1,3% krahasuar me muajin korrik 2026. Rritja është ndikuar nga grupet kryesore të COICOP-it: transporti (4,6 %), strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (0,8 %), mobilje, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinore shtëpiake (0,5 %), ushqime dhe pije joalkoolike (0,4 %), shëndetësi (0,4 %), informacion dhe komunikim (0,4 %), rekreacion, sport dhe kulturë (0,4 %), restorante dhe shërbime akomodimi (0,3 %), pije alkoolike, duhan dhe narkotikë (0,1 %), veshje dhe këpucë (0,1 %) dhe kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme (0,1 %).

Norma mujore dhe vjetore e inflacionit në % e matur nga IHÇK



Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2026 në %	VIII - 2026 2025=100	VIII - 2026 VII - 2026	VIII - 2026 VIII - 2025
00	TË GJITHA ARTIKUJT	1000.0	108.1	1.3	7.3
01	Ushqime dhe pije joalkoolike	327.6	103.5	0.4	2.6
02	Pije alkoolike, duhan dhe narkotikë	57.6	105.3	0.1	5.1
03	Veshje dhe këpucë	42.6	102.9	0.1	3.0
04	Strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse	94.1	111.1	0.8	11.8
05	Mobilje, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinore shtëpiake	77.7	103.5	0.5	3.4
06	Shëndetësi	29.6	104.8	0.4	4.2
07	Transporti	188.5	123.5	4.6	21.1
08	Informacion dhe komunikim	39.6	100.4	0.4	0.6
09	Rekreacion, sport dhe kulturë	29.5	105.1	0.4	3.4
10	Shërbimet arsimore	8.3	99.7	0.0	-0.5
11	Restorante dhe shërbime akomodimi	43.1	106.7	0.3	5.4
12	Sigurime dhe shërbime financiare	19.2	100.1	0.0	0.0
13	Kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme	42.6	104.1	0.1	3.8

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin gusht 2026, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation>